

VENDIM
Nr. 806, datë 3.12.2012

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
OBJEKTET E INVESTIMEVE, NË KUADËR TË FONDIT TË ZHVILLIMIT TË RAJONEVE, PËR
VITIN 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e autoriteteve kontraktore për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, si dhe për lidhjen e kontratave përkatëse për investimet sipas vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, deri më 31 dhjetor 2012.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore, autoritetet kontraktore dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha